



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 375, datë 02.12.2021

**PËR CAKTIMIN E Z. ARBEN NIKA, NËPËRMJET PROCEDURËS SË
NGRITJES NË DETYRË, NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KURBIN**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6 dhe 52 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 28 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë **Z. Arben Nika** në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.
2. Z. Arben Nika do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin nga data 02.12.2021 - 01.12.2024.
3. Të njoftohen për këtë vendim Z. Arben Nika, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
MOISL BUDA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**